



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 30.10.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja - kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit të zhvilluara në datat 22 dhe 23 tetor 2018.
2. Seancë dëgjimore me kandidaturat e propozuara nga Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste për vendet vakante të dy anëtarëve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Vlerësimi i përmbushjes së kriterëve ligjore dhe i meritës së kandidaturave të propozuara.

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Bashkim Fino, Bledar Çuçi, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Elena Xhina, Spartak Braho, Xhemal Qefalia.

Mungojnë:

Enkelejd Alibeaj, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Astrit Veliaj, Fatmir Mediu, Nasip Naco, Silva Caka, Adnor Shameti dhe Tom Doshi.

Të ftuar:

Bledar Skenderi – kandidat i propozuar nga Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste për vendet vakante të dy anëtarëve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Rezarta Bitri – kandidate e propozuar nga Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste për vendet vakante të dy anëtarëve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja – Le të hyjnë mediet!

Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme. Kuromi formohet, kështu që vazhdojmë me pikat që kemi në rendin e ditës.

Si pikë të parë kemi miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit të zhvilluara në datat 22 dhe 23 tetor 2018. A ka vërejte nga kolegët për procesverbalet? Nuk ka.

Miratohet.

Pikë e dytë e rendit të ditës është seancë dëgjimore me kandidaturat e propozuara nga Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste për vendet vakante të dy anëtarëve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Komisioni ynë është komision përgjegjës për shqyrtimin dhe miratimin e këtyre kandidaturave. Relator është kolegu Bledar Çuçi.

Grupi Parlamentar i PS-së, bazuar në nenin 14, pika 1, germa “a”, të Kodit Zgjedhor si dhe në nenin 111, pikat 3 dhe 7, të Rregullores së Kuvendit për plotësimin e dy vendeve vakante që rezultojnë pas përfundimit të mandatevetë mbajtura nga zoti Hysen Osmanaj dhe zonja Vera Shtjefni, propozime të partisë që ka numrin më të madh të vendeve nga partitë e shumicës parlamentare, i ka propozuar Komisionit të Ligjeve dy kandidatura, zotin Bledar Skënderi dhe zonjën Rezarta Bitri.

Për të bërë një prezantim të kandidaturave dhe të procedurës së ndjekur nga Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste në lidhje me kandidaturat e propozuara në mbledhjen e komisionit kemi të pranishëm kryetarin e grupit parlamentar të shumicës, zotin Taulant Balla. Ndërkohë, dua të sjell në vëmendje të komisionit dhe të opinionit publik faktin që Komisioni i Ligjeve është vënë në dijeni nga KQZ-ja për vakancat e krijuara, pastaj Shërbimi i Monitorimit të Institucioneve të Pavarura të Kuvendit ka përpiluar materialin përkatës për procedurën e parashikuar nga Rregullorja e Kuvendit për plotësimin e vendeve vakante.

Ndërkohë, Kryetari i Kuvendit në disa seanca plenare me radhë, bazuar në Rregulloren e Kuvendit, u ka bërë thirrje grupeve parlamentare, të cilat, sipas Kodit Zgjedhor, kanë të drejtën të paraqesin kandidaturat për plotësimin e vendeve vakante në KQZ. Deri më tani rezulton se kandidaturat i ka paraqitur vetëm Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste.

Pa humbur kohë, ia kaloj fjalën kryetari të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, zotit Taulant Balla, për të bërë një prezantim të kandidaturave dhe të procedurës së ndjekur.

Zoti Balla, fjala është për ju.

Taulant Balla – Zoti kryetar,

Të nderuar anëtarë të Komisionit të Ligjeve,

Gjej rastin t'ju falënderoj për shpejtësinë që i dhatë këtij procesi, i cili është shtyrë nëafatet përfundimtare, duke rrezikuar edhe vijueshmërinë e një institucioni shumë të rëndësishëm, sikurse është institucioni i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve! Ashtu siç ju informoi kryetari i komisionit, edhe ne, kryetarët e grupeve parlamentare, në fakt, këtu dua të përmend që për këtë çështje janë njoftuar nga Kryetari i Kuvendit dhe nga Shërbimi i Monitorimit të katër kryetarët e grupeve parlamentare, të grupeve të regjistruara në Kuvendin e Shqipërisë. Mbi bazën e këtij njoftimi kemi nisur procedurat e propozimit të kandidaturave për zëvendësimet përkatëse. Siç u theksua këtu, është Kodi Zgjedhor, neni 14 i tij, që rregullon procedurën e propozimit dhe të zgjedhjes së anëtarëve të KQZ-së, pikërisht pika 1, germa “a” e këtij neni. Partia Socialiste e Shqipërisë, në cilësinë e partisë që ka numrin më të madh të vendeve nga partitë e shumicës parlamentare, duhet të propozojë kandidaturat për vendet vakante në mandatet e mbajtura më parë nga zoti Hysen Osmanaj dhe zonja Pranvera Shtjefni, të cilat janë mandate të mbajtura si përfaqësues të shumicës parlamentare në legjislaturën e kaluar.

Pas konsultimit, në respektim të dispozitave të Kodit Zgjedhor, neni 14, pika 1, germa “b” “Për respektimin e kuotës gjinore”, e cila për ne ka një rëndësi të veçantë, përkatësisht u depozituan 4 kandidatura për 2 vakancat e njoftuara. 2 kandidaturat e propozuara për vakancën e parë, pas përfundimit të mandatit të mbajtur nga zoti Hysen Osmanaj, ishin zonja Rrezarta Bitri dhe zoti Arenc Çela, dhe zonja Edlira Kokona dhe zoti Bledar Skënderi për mandatin e mbetur vakant për shkak të mbarimit të mandatit të zonjës Pranvera Shtjefni. Pra, jemi në kushtet e parashikuara nga Kodi Zgjedhor, fillon procedura me 4 kandidatura dhe më pas, në cilësinë e kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, sipas parashikimeve të nenit 14, kam pritur që përfaqësuesit e grupeve parlamentare të ushtronin të drejtat e tyre dhe të bëheshin pjesë e procedurave propozuese dhe të përzgjidhnin kandidaturat për vendet e mbetura bosh në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Siç jeni në dijeni, nga grupet e tjera parlamentare nuk janë depozituar ende propozime, për pasojë, në kushtet kur grupet e tjera parlamentare, edhe pas përfundimit të gjithë afateve, (këtu dua të kujtoj se është bërë tri herë thirrje nga ana e Kryetarit

të Kuvendit për plotësimin e vakancave) nuk di nëse grupet e tjera parlamentare të kenë vendosur të mos e ushtrojnë të drejtën e ofruar nga neni 14 i Kodit Zgjedhor, por, kjo është një çështje, e cila u përket tërësisht grupeve të tjera parlamentare, edhe pas konsultimit me të gjithë anëtarët e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste dhe pas një vlerësimi të asaj që ju përmendët me të drejtë se çfarë përfaqësojnë 4 kandidaturat, kam ardhur sot t’iu propozoj Komisionit të Çështjeve Ligjore, Administratës Publike dhe të Drejtave të Njeriut, në cilësinë e komisionit përgjegjës, të përcaktuar nga Rregullorja e Kuvendit, përkatësisht 2 kandidatura: zonjën Rrezarta Bitri, bashkë me dokumentacionin mbështetës, CV-në, eksperiencën profesionale dhe vlerësimet maksimale të punës të kryer deri tani dhe zotit Bledar Skënderi me po të njëjtat argumente në dosjen përkatëse, të cilat janë depozituar. Keni të gjithë eksperiencën profesionale, CV-në dhe të gjithëka tjetër që ju nevojitet për të plotësuar bindjen tuaj lidhur me kandidaturat e propozuara.

Në mbështetje të nenit 14, pika 1, germa “ a” të Kodit Zgjedhor, ne propozojmë që dy kandidaturat e mësipërme, Rezarta Bitri dhe Bledar Skënderi të zgjidhen në pozicionet e mbajtura më parë nga zonja Vera Shtjefni dhe zoti Hysen Osmani.

Pas seancës dëgjimore këto dy kandidatura t’i shkojnë seancës plenare për votim dhe është Kuvendi i Shqipërisë ai që merr në shqyrtim dhe voton për dy vendet vakante në KQZ, duke garantuar edhe vijueshmërinë e punës së këtij institucioni.

Bashkëlidhur keni të gjithë dokumentacionin mbështetës për secilën nga kandidaturat.

Faleminderit, zoti kryetar dhe anëtarëve të Komisionit të Çështjeve Ligjore Administratës Publike dhe të Drejtave të Njeriut!

Ulsi Manja- Faleminderit, zoti Balla!

Sipas nenit 111, pikat 3 dhe 7, të Rregullores së Kuvendit, sapo komisioni merr në shqyrtim kandidaturat e propozuara nga grupet parlamentare, ka detyrimin ligjor të shqyrtojë përmbushjen e kriterëve kushtetuese e ligjore dhe meritën e secilës kandidaturë përpara se ato t’i kalojnë për votim seancës plenare.

Përpara se kandidatët të thirren në seancë dëgjimore për të bërë vlerësimin e meritës të secilit prej kandidatëve, unë dua t’ia kaloj fjalën kolegut Bledi Çuçi, si relator, t’i bëjë të ditur komisionit, por edhe opinionit publik përmbushjen e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidatëve të propozuara nga Partia Socialiste.

Zoti Çuçi, fjala për ju.

Bledar Çuçi – Faleminderit, kryetar!

Nuk dua të zgjatem shumë, sepse kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste ishte shterues në paraqitjen që u bëri dy kandidaturave. Nga verifikimi ynë, si komision, lidhur me plotësimin e kriterëve, të dyja kandidaturat e propozuara për të shkuar në seancë, në bazë të Kodit Zgjedhor, kanë rezultuar se i plotësojnë më së miri kriteret dhe kushtet për të qenë anëtarë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe mund t'ju them që edhe nga hulumtimi i hollësishëm për sa i përket integritetit jo vetëm profesional, por edhe njerëzor të kandidaturave, mendoj se është në nderin e këtij komisioni që t'i propozojmë seancës plenare këto dy kandidatura për t'u miratuar dhe për të qenë anëtarë të ardhshëm të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Prandaj ftoj kolegët që pas seancës dëgjimore që do të bëjmë me dy kandidaturat, t'ia përcjellim seancës plenare për miratim propozimin tonë në lidhje me këto dy kandidatura.

Faleminderit!

Ulsi Manja- Faleminderit, zoti Çuçi!

Vazhdojmë seancën dëgjimore me kandidatët e propozuar. Sipas rendit alfabetik, thirrret kandidati Bledar Skënderi.

Zoti Skënderi, mirë se erdhët në këtë seancë dëgjimore për vendin vakant të krijuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve!

Kandidatura juaj është propozuar nga Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste bazuar në nenin 14, pika 1, germa “a”, të Kodit Zgjedhor. Kandidatura juaj propozohet për vendin e mbetur bosh pas përfundimit të mandatit të mbajtur nga zonja Vera Shtjefni. Ju kërkoni një mandat tjetër për në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, dokumentacioni juaj është në tavolinat e kolegëve, do t'ju lutem shkurtimisht arsyet që ju shtynë të kërkoni një mandat tjetër në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Bledar Skënderi- Ju faleminderit të gjithëve!

Unë kam pasur një mandat plotësues në KQZ dhe mendoj se një mandat i ri do të më plotësonte edhe në aspektin profesional.

Jam shumë i nderuar që jam propozuar për një mandat të ri në KQZ. Gjatë periudhës që kam qenë atje kemi kaluar një palë zgjedhje dhe besoj se kemi arritur të përmirësojmë standardet gjatë procesit zgjedhor. Përmirësimi është një evolucion i vazhdueshëm dhe mendojmë që në zgjedhjet e ardhshme të rrisim standardet e procesit zgjedhor.

Ulsi Manja - Faleminderit, zoti Skënderi!

Ka pyetje nga kolegët?

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit edhe kryetarit të grupit parlamentar!

Faleminderit, zoti Skënderi!

Ndoshta duhet të flisnit diçka më tepër për të pasqyruar atë çfarë keni në CV dhe doni të bëni në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, aq më pak që keni pasur mandat plotësues dhe jo të plotë.

Për t'ju ndihmuar, kam një pyetje pak specifike, megjithëse keni mandat plotësues dhe jo të plotë, si ish- anëtarë i KQZ-së: si ka mundësi që regjistruat subjektin politik PD jashtë afatit për zgjedhjet e vitit 2017? Bëtë një shkelje ligjore, ndërkohë që kërkonin një mandat të plotë?

Ulsi Manja - Po, zoti Skënderi.

Bledar Skënderi – Pyetja është pak intriguese, prandaj edhe përgjigjja ime do të jetë pak e tillë.

E para, zoti Fino, ka qenë kandidat për deputet në zgjedhjet e vitit 2017 dhe si i tillë ka qenë subjekt zgjedhor. Në këtë kuadër ka...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja- Ju lutem, ta lëmë zotin Skënderi të mbarojë, të japë përgjigjen!

Bledar Skënderi - Më lejoni të dal te thelbi i çështjes.

Në bazë të Kodit Zgjedhor, çdo kandidat për deputet ka pasur të drejtën e ankimit kundër vendimit të KQZ-së. Kundër vendimit tonë nuk është bërë asnjë ankim, as nga subjektet zgjedhore, as nga kandidatët për deputetë. Pra, unë mendoj se procedura ka qenë e saktë.

E dyta, ne kemi si mision garantimin e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme në Republikën e Shqipërisë dhe ky qëllim prevalon mbi çdo rregull apo normë të vogël të shkruar. Mund t'ju jap një shembull shumë relativ: nxjerrja e rezultateve pas përfundimit të zgjedhjeve, ka një afat nga KQZ-ja jo më vonë se ora 20:00 e ditës pasardhëse, pavarësisht se vendimet merren më pas, a ka sjellë kjo gjë zgjedhje të pavlefshme? Jo, absolutisht, sepse prevalon qëllimi kryesor që është garantimi i zgjedhjeve të lira. Në këtë kuadër edhe ne që t'i garantojmë publikut dhe spektrit politik një pjesëmarrje sa më të gjerë në zgjedhje, menduam se mund të anashkalojmë një rregull të vogël që nuk është determinant, për një qëllim më të lartë dhe më të mirë.

Faleminderit!

Ulsi Manja- Faleminderit, zoti Skënderi!

Ka pyetje të tjera nga kolegët?

Po, zonja Bushka.

Klotilda Bushka - Zoti Skënderi, ju keni një eksperiencë të gjatë në fushën e të drejtës, por edhe në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, keni përjetuar situata që nuk mund të quhen shumë të qeta, po i referohem zgjedhjeve të kaluara të vitit 2017, ku vendi kaloi një periudhë që do të duhej të riparohet nga ju edhe me vendimet, të cilat ndoshta nuk ishin tërësisht në përputhje me rregullat, por të paktën arritëm të kishim krijimin e një klime të mirë politike për zgjedhjet e përgjithshme, ku patëm një pjesëmarrje të mirë.

Pyetja ime ka të bëjë me diçka, që e shqetëson të gjithë opinionin publik sot, ne duhet të kthejmë besimin e publikut te sistemi zgjedhor dhe për këtë arsye kemi ngritur një komision për reformën zgjedhore, me pika të qarta në axhendën e tij, për sa i takon përafrimit të standardeve me ato ndërkombëtare, sipas rekomandimeve të OSBE\ODIHR-it. Një nga çështjet thelbësore që u pa edhe në fushatën e kaluar, që dha rezultat, ka të bëjë me transparencën në veprimtaritë elektorale.

Për sa u takon financave të partive politike, financave për fushatat zgjedhore, ne jemi në procesin e hartimit të një kuadri më të plotë. Sot që flasim kuadri ligjor i KQZ-së për sa i përket kontrollit të financave të partive politike dhe të fondeve që përdoren për fushatat zgjedhore, a është i tillë që publiku t'i jepet një transparencë e plotë?

Deri sot, a ka qenë puna juaj një punë thelbësore, pavarësisht një kuadri të tillë, që sot mendojmë se duhet të jetë më i plotë, apo ka qenë thjesht rutinë, vetëm në vlerësimin e të ardhurave të deklaruara dhe shpenzimeve të bëra. Pra, ju si Komision Qendror i Zgjedhjeve, ju vetë si anëtar i komisionit, a keni kërkuar të bëhen hetime të thelluara apo jeni mjaftuar vetëm me procedurat rutinë të kontrollit të llogarive matematikore?

Ulsi Manja – Zoti Skënderi.

Bledar Skënderi – U hap një temë shumë e ndjeshme, që është çështja e financimit të partive.

Ne si Komision i Qendror të Zgjedhjeve, sidomos këta dy vjet, kemi bërë goxha përparime dhe hapa goxha të rëndësishme në këtë kuadër. Për herë të parë kanë pasur efekt të ndjeshëm rregullimet ligjore që janë bërë në kuadrin e financimit të partive, gjë që u pasqyrua edhe gjatë fushatës zgjedhore. Ne veprojmë brenda një kuadri ligjor aktual. Ky kuadër...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Hyseni, besoj se pyetjes së parë i dhashë përgjigje shteruese, kështu që nuk besoj se ka vend më për komente. Edhe ju keni qenë kandidat për deputet, kishit të drejtën e ankimit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem, ju lutem! Le ta përfundojë përgjigjen për pyetjen e zonjës Bushka.

Zoti Skënderi, a mund të vazhdoni me përgjigjen për pyetjen e koleges Bushka?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, zonja Hysi!

Zoti Skënderi, mund të vazhdoni!

Bledar Skënderi – Po, të qëndrojmë brenda kuadrit të pyetjes.

Për momentin, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka tagër shumë të kufizuar, sepse ne nuk jemi organ hetimi. Ne thjesht administrojmë provat që sjellin palët gjatë procesit. Ne monitorojmë shpenzimet e fushatës, monitorojmë pasqyrat financiare që sjellin partitë politike. Jemi duke punuar për përmirësimin e bazës ligjore. Kemi propozuar disa ndryshime në kuadër të transparencës, për të ulur nivelin e deklarimit që subjektet zgjedhore apo individët bëjnë në kuadër të donacionit për partitë politike. Ndoshta ka nevojë edhe për një zgjerim të kuadrit ligjor, që ne të na jepet tagër pak më tepër. Jo për të bërë hetim, sepse hetimet i bëjnë organet ligjzbatuese në vend, po për të pasur më shumë të drejta, në mënyrë që ne të hyjmë pak më thellë në kuadër të hetimit financiar të partive politike.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Skënderi!

Po, zoti Hyseni, mund ta bëni pyetjen!

Alket Hyseni – Faleminderit!

Zoti Skënderi, unë jam një nga propozuesit, një nga firmëtarët për kandidaturën tuaj, sepse kam pasur kënaqësinë t'ju njoh prej vitesh, arsye për të cilën nuk kam as dyshimin më të vogël në lidhje me cilësitë tuaja për këtë pozicion, por më intriguat gjatë përgjigjes së pyetjeve të kolegëve. Mbi këtë bazë, do të ndërtoj një pyetje të re: Cili është kriteri që ju vlerësoni, se kur mund të keni kartën morale për të shkelur ndonjë normë të caktuar? Ku e gjeni këtë kompetencë? Kjo nisur edhe nga fakti që i komunikuat zonjës Bushka se ju nuk kryeni hetim të thelluar, ndërkohë që ju kujtoj se keni një rezolutë të Kuvendit të Shqipërisë, e cila ju ngarkon me detyrën e bërjes së hetimit të thelluar.

Prandaj, mos keni ngarkesë më tepër se ç'duhet në lidhje me faktin e të dhënit të zgjedhjeve moral politik, ndërkohë që s'është detyra juaj? Zgjedhjeve ua jep moralin politik

votuesi shqiptar, por patjetër edhe partitë politike e subjektet zgjedhore që marrin pjesë. Ju jeni administratorë të këtij procesi. Prandaj, ju lutem, na thoni se ku e ndani këtë vijën e hollë mes së drejtës morale për të shkelur ndonjë normë në ndonjë rast të caktuar, ose për ta harruar ndonjë normë, sado normë e vogël apo rregull i vogël, dhe në raste të tjera nuk ndërhyjnë edhe kur keni një rezolutë për të bërë hetim të thelluar.

E them këtë, sepse kemi pasur situata dhe fakte të njohura botërisht, që subjekte të caktuara politike kanë mashtruar në lidhje me financimet politike. Duke pasur një situatë të tillë, ju nuk e keni gjetur kartën morale për të kaluar më tej asaj që shkruhet në detyrat tuaja, thoni ju, ndërkohë që keni edhe rezolutën.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Po, zoti Skënderi.

Bledar Skënderi – I nderuar zoti Hyseni, po e përsëris edhe një herë se ne si institucion kemi si mision dhe qëllim garantimin e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme në Republikën e Shqipërisë. Ky qëllim prevalon mbi çdo normë të ngurtë apo të vogël, të shkruar në atë kod.

Ne që ndodhemi në këtë tavolinë jemi të gjithë juristë, sepse po të ishte se ligji lexohet kaq bardh e zi sa ç'po mundoheni ta shpjegoni ju, nuk ka nevojë të mbarosh juridikun; merr atë kodin aty, e hap dhetë thuash që kjo norma ligjore këtu...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Prisni, se do të kaloj edhe te pjesa e dytë e përgjigjes.

Ky ishte një rregull, i cili garanton që partitë politike të hyjnë në zgjedhje. A është shkelur nga ana e KQZ-së? Nuk quhet shkelje kjo, sepse nuk është një rregull bazë që, për shembull, e regjistruam partinë pas datës së zgjedhjeve dhe çuam në dështimin e zgjedhjeve. Jo, ne garantuam që të zhvillohej një proces i lirë dhe i ndershëm, me pjesëmarrjen e të dyja palëve.

Në këtë kuadër, e thashë, prevalon qëllimi kryesor, që është garantimi i zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, çka prevalon mbi çdo rregull, aq më tepër kur kjo është bërë mbi vullnetin politik të të gjitha palëve pjesëmarrëse në proces dhe këtu nuk ka asgjë për të diskutuar.

Në lidhje me financimin e partive politike, nuk është se ne i kemi duart kaq të lidhura për momentin, ne i kemi bërë përpjekjet tona, si dhe këtë lloj çështjeje e kemi relatuar pranë organeve ligjzbatuese në vend, pranë organeve të hetimit. Pastaj, është detyrë dhe kompetencë e tyre, është kompetencë e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë që të kryejë hetime kur ka shkelje.

Ne e kemi bërë evident faktin edhe në seancat publike, edhe nëpërmjet shkresave zyrtare. Kështu që ne jemi në rregull, pasi e kemi bërë detyrën tonë si institucion.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Skënderi!

Fjalën e ka kërkuar zoti Qefalia.

Xhemal Qefalia – Faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt, edhe unë për zotin Skënderi ndaj opinionin pozitiv, sepse e njoh prej vitesh, por kam një pyetje, që ndoshta është edhe në interes të publikut. Në përfundim të zgjedhjeve, organizatat ndërkombëtare, OSBE-ja dhe ODIHR-i, kanë reflektuar dhe kanë dhënë sugjerimet përkatëse. Cili është mendimi juaj lidhur me sugjerimet që ka bërë OSBE-ODIHR-i? A ka një reflektim nga politika dhe nga vetë KQZ-ja?

Faleminderit!

Ulsi Manja – Po, zoti Skënderi.

Bledar Skënderi – Pas çdo palë zgjedhjesh është praktikë e OSBE-ODIHR-it të bëjë raportin përfundimtar për zgjedhjet. Sigurisht, ka lënë detyra më shumë për klasën politike dhe diçka më pak për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Ne kemi reflektuar, kemi bërë një plan pune për zbatimin e rekomandimeve të OSBE-ODIHR-it, i kemi bërë disa rekomandime edhe klasës politike në vend për përmirësimin e sistemit zgjedhor, por topi ka ngelur në tavolinën tuaj, si klasë politike, për të zbatuar me përpikëri rekomandimet e tyre.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Skënderi!

Ka pyetje të tjera nga kolegët? Nuk ka.

Shumë faleminderit për prezencën tuaj në komision, zoti Skënderi!

Ditë të mbarë!

Bledar Skënderi – Faleminderit juve!

Ulsi Manja – Vazhdojmë me kandidatin tjetër në radhë, me zonjën Rezarta Bitri.

Zonja Bitri, mirë se erdhët në Komisionin e Ligjeve në këtë seancë dëgjimore!

Rezarta Bitri – Përshëndetje!

Ulsi Manja – Edhe ju jeni një nga kandidaturat e propozuara nga Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste për plotësimin e vendit të mbetur bosh pas përfundimit të mandatit të mbajtur nga zoti Hysen Osmanaj dhe e keni pranuar kandidimin. Dokumentacioni që ju keni paraqitur pranë komisionit është i plotë dhe, sipas relatorit, është në përputhje me kërkesat e Kushtetutës dhe të ligjit.

Pra, jeni thirrur në seancën e sotme dëgjimore për t'u bërë të ditur edhe anëtarëve të komisionit, edhe opinionit publik, arsyet që ju shtynë ta pranoni këtë kandidim që ju ofroi Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste.

Fjala është për ju.

Rezarta Bitri – Faleminderit!

I nderuar kryetar i komisionit,

Të nderuar anëtarë,

Së pari, dua të shpreh falënderimin tim për mbështetjen për këtë kandidaturë dhe propozimin, por, sigurisht, mbi të gjitha, për besimin e dhënë për një funksion të tillë, i cili është primar për të gjithë funksionimin e demokracisë dhe shtetit të së drejtës në tërësi!

Në fakt, e mirëprita me shumë kënaqësi dhe prandaj jam këtu sot për të dhënë këtë miratim, ndoshta edhe në një ambient më të gjerë dhe më tej pastaj nëse do të vijojnë procedurat sipas ligjit.

Arsyeja pse jam këtu sot është dëshira dhe pasioni që kam për profesionin tim. Unë jam juriste, me një karrierë prej 18 vjetësh, ndoshta një karrierë ende e pakonsoliduar, sepse vitet janë ende përpara, por ndoshta edhe një karrierë që më jep sigurisht, një garanci dhe një dëshirë të madhe për të kontribuar, që gjithçka që kam akumuluar në këto vite, t'i vendos tashmë në funksion të një institucioni kaq të rëndësishëm, siç është KQZ-ja.

Sigurisht, unë vij nga një historik shumë teknik dhe shumë profesional dhe kam qenë gjithmonë e interesuar për atë që ndodh në vend.

Sigurisht, pjesa e sistemit zgjedhor dhe mbarëvajtja e tij, besoj se janë thelbësore për funksionimin e të gjitha institucioneve të tjera, të 3 pushteteve të tjera dhe besoj se në këtë pikë gjithçka kam akumuluar, do të jetë në shërbim të këtij institucioni. Po pres me shumë dëshirë për të kontribuar në mënyrë të paanshme, profesionale e mbi të gjitha, me integritet. Besoj se KQZ është një institucion që kërkon përtej profesionalizmit, edhe disa virtyte, të cilat unë besoj se i përfaqësoj denjësisht.

Pa ju marrë shumë kohë, eksperiencia ime është fokusuar së tepërmi në fushën e ligjit. Unë vij nga një karrierë që i përket më së shumti sferës shtetërore.

Së fundi, prej vitit 2017 jam një prakticiene e së drejtës (avokate). Më parë, pas përfundimit të Fakultetit Juridik, kam shërbyer në strukturat juridiko-profesionale të Ministrisë së

Drejtësisë, si dhe në sistemin e drejtësisë (në Gjykatën e Lartë dhe në Gjykatën Kushtetuese). Në këtë prizëm besoj se ligji është një nga armët e mia të forta.

Gjithashtu, unë besoj se ligji në të gjithë komponentët e tij është pasion i çdo juristi. Besoj se KQZ e ka të rëndësishëm profilin e juristit, respektimin e ligjit dhe interpretimin e tij në mënyrën e duhur.

Përveç kësaj, unë kam edhe një formim akademik. Unë jam diplomuar në vitin 2000 në Fakultetin Juridik dhe kam ndjekur më tej studimet e thelluara në nivelin Master dhe tashmë mbaj edhe gradën “Doktor i shkencave juridike”.

Ulsi Manja - Faleminderit, zonja Bitri!

Ka pyetje nga kolegët?

Urdhëroni, zonja Bushka!

Klotilda Bushka - Faleminderit, zonja Bitri, që jeni sot këtu!

Në fakt keni një CV shumë të pasur. Ju thatë se në vitin e fundit keni qenë praktikante avokate. Si praktikante e ligjit keni qenë qëkur keni mbaruar shkollën dhe unë po shoh se ju keni një CV shumë të pasur në aktivitetin që lidhet me të drejtën. Unë e vlerësoj karrierën tuaj. Nga mënyra se si prezantoheni dhe vizionin që keni si kandidate për të qenë anëtare e KQZ-së, më bën të besoj se ne do ta shtojmë profesionalizmin dhe paanësinë, si dhe do të rrisim transparencën me kandidatura si juaja.

Pyetja që kam, ka të bëjë me faktin se tashmë në kuadër të një reforme zgjedhore në Shqipëri po flitet gjithmonë e më shumë për paanshmërinë e organeve të zgjedhjeve nga politika dhe sigurisht, Komisioni i Reformës Zgjedhore po punon në këtë drejtim.

Unë doja të dija mendimin tuaj se sa mund të arrihet në Shqipëri që të kemi organe zgjedhore të çdo niveli, të cilat mund të jenë tërësisht të ndara nga politika, mund të jenë tërësisht me profesionistë, me njerëz si të karrierës suaj ose të ngjashme. Pra, nisur nga përvoja juaj në sektorin e së drejtës, a mund të nisim një rrugë e cila na çon drejt një qëllimi të tillë?

Ulsi Manja- Po, zonja Bitri.

Rezarta Bitri- Faleminderit!

Pyetja është shumë e rëndësishme. Si njohëse e procesit legjislativ prej shumë vitesh, e vlerësoj shumë si të rëndësishëm faktin që ligjet duhet t’i hartojmë, t’i propozojmë dhe t’u japim një format juridik. KQZ-ja është një institucion kushtetues dhe gëzon një status të pavarur nga politika, por për ta shtrirë edhe në nivelet e tjera unë vlerësoj se duhet një studim shumë i mirë.

Vërtet duam të arrijmë një objektiv, por kjo do një analizë shumë të mirë paraprake, të cilën unë nuk mund ta bëj në këtë moment. Pra, do të ishte efektive që para se të merrnim masa të tjera legislative, përkthimi në nisma ligjore për të arritur këtë lloj pavarësie është një objektiv që edhe në realitetin shqiptar nuk ka pse të mos arrihet. Ne po ecim drejt kësaj pavarësie, luftojmë çdo ditë në të gjitha institucionet. Unë edhe aty ku kam punuar janë institucione ku kjo është sfida e përditshme e çdo profesionisti, është objektiv i arritshëm, por do të dojë kohën dhe studimin e vet. Unë besoj se do të dojë kohën e vet, si proces mund të jetë afatmesëm, por i arritshëm.

Ulsi Manja- Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Bitri!

Kam lexuar me vëmendje të gjithë dosjen që ju keni depozituar dhe ndjehem mirë që jam një nga firmëtarët që kam mbështetur kandidaturën tuaj për të qenë anëtare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, jo vetëm për faktin që përfaqësoni atë që me të drejtë kolegu Çuçi vuri në dukje, balancën gjinore, por për shkak të një CV-së dhe karrierës shumë të gjatë dhe shumë të pasur që ju keni.

Duke pasur parasysh përvojën tuaj të gjatë në Ministrinë e Drejtësisë në të gjithë sektorët e opionencës, kodifikimit, në Gjykatën e Lartë, në Gjykatën Kushtetuese, në sektorin privat të konsulencës, dhe institucione ndërkombëtare, cila do të ishte risia që do të sillnit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, duke pasur parasysh se karriera juaj ka qenë më shumë civile, tregtare, e të tjera?

Rezarta Bitri – Ju falënderoj për adresimin e pyetjes dhe përmbajtjen e saj. Kjo është një nga pyetjet që ndonjëherë duket e thjeshtë, por është edhe e vështirë për të thënë se çfarë risie do të sjell unë. Unë në këtë tavolinë ndihem e nderuar, por edhe si në terrenin tim, sepse jemi të gjithë njerëz që i përkasim një profili ligjor. Sigurisht, duke pasur këtë eksperiencë në analizë, në hartim, në interpretim dhe në një zbatim korrekt të ligjit e mendoj si risi për ta ofruar unë si një anëtare potenciale e re, pasi anëtarët aktualë e kanë profilin e tyre dhe bëjnë këtë punë të përditshme. Gjithashtu, unë mendoj se duke i pasur të gjithë komponentët së bashku do të jem pjesë e një kontributi në një vendimmarrje të drejtë dhe profesionale, në një interpretim të gjerë, korrekt, dhe të paanshëm për të ofruar atë që të gjithë kemi nevojë, zgjedhjet e lira dhe të ndershme, për të pasur konceptin e demokracisë që duam të gjithë.

Vasilika Hysi – Faleminderit!

Ulsi Manja- Faleminderit, zonja Bitri!

A ka pyetje të tjera?

Nuk ka.

Zonja Bitri, faleminderit për prezencën tuaj në komision për këtë seancë dëgjimore!

Ditë të mbarë!

Rezarta Bitri – Faleminderit!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 30.10.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Vlerësimi i përmbushjes së kriterëve ligjore dhe i meritës së kandidaturave të propozuara.

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Bashkim Fino, Bledar Çuçi, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Elena Xhina, Spartak Braho, Xhemal Qefalia.

Mungojnë:

Enkelejd Alibeaj, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Astrit Veliaj, Fatmir Mediu, Nasip Naco, Silva Caka, Adnor Shameti dhe Tom Doshi.

Ulsi Manja - Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës.

Bazuar në nenin 111, pika 1 e Rregullores së Kuvendit, dy kandidaturat e propozuara nga Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste janë të mbështetura me nga 28 firma, jo më pak se 28 deputetë të shumicës parlamentare. Në përfundim të kësaj seance dëgjimore, bazuar në pikat 3 dhe 7 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni i Ligjeve bën vlerësimin e përmbushjes së kriterëve ligjore dhe të meritës së kandidatëve të propozuar nga Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste, ndaj do t'i lutesha relatorit, zotit Çuçi...

Zoti Çuçi, nuk qenka i pranishëm.

Atëherë 2 minuta pushim sapo zoti Çuçi të kthehet në tryezën e komisionit.

(Pas pushimit)

Zoti Çuçi, bazuar në pikat 3 dhe 7 të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, pas seancës dëgjimore me kandidatët e propozuar, ky komision bën një vlerësim të përmbushjes së kriterëve ligjore dhe meritës së kandidatëve të propozuar. Pra, para se t'i kalojmë kandidatët në votim, pas kësaj seance dëgjimore, çfarë u sugjeron relatori kolegëve të komisionit?

Bledar Çuçi - Pas seancës dëgjimore jam edhe më shumë i bindur se ky komision duhet t'i sugjerojë seancës plenare miratimin e të dy kandidaturave për 2 vendet vakante të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Çuçi!

Bazuar në nenin 111, pika 7, të Rregullores, hedhim në votim kandidaturat e propozuara nga Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste.

Në fillim hedhim për votim kandidaturën e zonjës Rezarta Bitri, kandidaturë e propozuar nga Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste, për plotësimin e vendit të mbetur bosh pas përfundimit të mandatit të mbajtur nga zoti Hysen Osmanaj. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet kandidatura e zonjës Rezarta Bitri, për t'ia përcjellë seancës plenare për votim.

Kalojmë në kandidaturën e zotit Bledar Skënderi. Edhe kjo kandidaturë është propozuar nga Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste për plotësimin e vendit të mbetur bosh pas përfundimit të mandatit të mbajtur nga zonja Vera Shtjefni. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet kandidatura e zotit Bledar Skënderi.

Në përfundim, bazuar në nenin 14, pika 1, shkronja “a”, të Kodit Zgjedhor, si dhe në nenin 111, pikat 3 dhe 7 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni i Çështjeve Ligjore, Administratës Publike dhe të Drejtave të Njeriut në cilësinë e komisionit përgjegjës, referuar CV-së dhe dokumentacionit shoqërues, pasi mori në shqyrtim përmbushjen e kriterëve ligjore dhe meritën e dy kandidaturave të përcjella nga Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste, për plotësimin e dy vendeve që rezultojnë vakant pas përfundimit të mandateve të mbajtura nga zoti Hysen Osmanaj dhe zonja Vera Shtjefni dhe pasi hodhi në votim kandidaturat e propozuara nga Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste vendosi t’i përcjellë Kuvendit të Shqipërisë për votim përkatësisht kandidaturën e zonjës Rezarta Bitri dhe të zotit Bledar Skënderi për t’u emëruar si anëtarë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Me këtë vendim mbylлим për sot mbledhjen e Komisionit të Ligjeve. Mbledhja e radhës e komisionit do t’ju njoftohet nga sekretaria e komisionit. U urojmë suksese kandidatëve dhe shpresojmë që ditën e enjte të votohen edhe në seancë plenare nga deputetët e Kuvendit të Shqipërisë.

Faleminderit!

Ditë të mbarë!

Urime kandidatëve!

MBYLLET MBLEDHJA